



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4510 .Prot.

Rrogozhinë, më 25.10.2024

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Martë datë 29.10.2024 ora 13:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.09.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”.
- 7 - Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës së z. Haziz Jashar Kashari për ndihmë të menjëhershme financiare”.
- 8- Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 9- muajin e vitit 2024, si dhe informacion mbi ecurinë e punës për përgatitjen e Buxhetit të vitit 2025 nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave.
- 9- Raport nga Administratori i Njësisë Administrative Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024.
- 10- Njohje dhe shqyrtim me draft Paketën Fiskale të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025.
- 11- Të ndryshme.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mbledhet ditën e Hënë datë 28.10.2024 ora 11 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej-Anëtar.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

- Njoftoj të mbliidhet ditën e Hënë datë 28.10.2024 ora 11 : 30^{oo}, Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale, me këtë përbërje: Silvana Aliu - Kryetare, Fatmira Thartori - Zëvendëskryetare, Alime Hoxha - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.
- Njoftoj të mbliidhet ditën e Hënë datë 28.10.2024 ora 12 : 00^{oo}, Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infrastukturës, me këtë përbërje : Shpati Kolgega - Kryetar, Saimir Cani - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Gezime Met-hasani - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.
- Njoftoj të mbliidhet ditën e Hënë datë 28.10.2024 ora 12 : 30^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave, me këtë përbërje : Lulzim Hasa - Kryetar, Isa Halili - Zv.Kryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com